

Nacionale

REDAKTOR: Ilir Mirena
E-MAIL: ilir.mirena@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 275

Droga kontrabandohet edhe në burg

GJILAN, 25 NËNTOR — Policia në Gjilan ka bërë të ditur për kapjen e një substance, e cila dyshohet të jetë substancë narkotike. Naser Ibrahim, zëdhënës i SHPK-së në Gjilan, ka bërë të ditur se përgjegjësit e burgut, gjegjësisht oficerët korrektues kanë njoftuar se gjatë bastisjes së një personi, i cili

aktualisht gjendeje në Burgun e Qarkut në Gjilan për një vepër penale, është gjetur një sasi që dyshohet për narkotik. "Sasia e gjetur prej dy gramëve besohet të jetë e llojit marihuanë", tha zëdhënësi Ibrahim, duke shtuar se lidhur me rastin është njoftuar prokurori dhe janë nisur hetimet. I

pyetur nga Express, se si ka mundur që substanca narkotike të depertojë në burg, "nëpër kordonet kontrollues", zëdhënësi Ibrahim tha se nuk dua të spekuloj, për sa kohe që do të zhvillohen hetimet. "Hetimet, do të zbardhin të gjithë rastin", tha Ibrahim.

(Xhevat Latifi)

HETOHET PETKOVICI

Prokuroria është në pritje të dorëheqjes me shkrim të ministrit Petković, e më pas të fillojë hetimet për keqpërdorimet me buxhetin e kësaj ministrie. Bazë për hetime është raporti i auditorit, ku pa asnjë mbulesë janë shpenzuar 2.6 milionë euro.



FOTO: JETMIR IDRIZI

Nebih Maxhuni

nebih.maxhuni@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 25 NËNTOR — Së shpejti pritet të fillojnë hetimet ndaj ministrit të shkarkuar në Qeverinë e Kosovës, Slavisha Petković.

Përqendrimi rreth zgjidhjes së statusit dhe llogaritjet e politikës ndërkombëtare në Kosovë, në një mënyrë mbronin sigurinë e ministrit Petković.

Me urdhrin e Qeverisë së Kosovës që të japë dorëheqje, u janë hapur rrugë edhe hetimeve ndaj keqpërdorimeve dhe shpenzimeve të dyshimta të buxhetit të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete nga Slavisha Petković.

Hetimet nga Prokuroria do të zhvillohen kryesisht në shpenzimet enorme të buxhetit të MKK-së si dhe keqpërdorimet e këtyre mjeteve pa kurrfarë mbulesë nga Petković.

Raporti i Auditimit i bërë në këtë ministri, është bazë e hetimeve, ku në këtë raport të publikuar kohë më parë, nuk ka pa-

sur mbulesë për 2.6 milionë euro të harxhuara.

Prokurori në Gjykatën e Qarkut, Osman Kryeziu thotë për gazetë se me vetë faktin se ministri Petković është shkarkuar nga posti, atëherë dyshohet për keqpërdorime të mjeteve publike në këtë ministri.

Ai thotë se janë duke pritur raportin pikë për pikë të Auditorit Gjeneral dhe më pas të fillohet me hetimet.

"Sigurisht duhet të ndërmarim hapa konkretë, nëse ka keqpërdorime. Vetë fakti se ai është larguar, dyshohet se mund të ketë keqpërdorime", thotë Kryeziu.

Prokuroria është duke pritur vetëm dorëheqjen me shkrim të ministrit Slavisha Petković e më pas të fillohet nga e para sa u përket hetimeve në rastin Petković.

Kryeziu thotë se Prokuroria mund të fillojë hetimet, por para se kjo të ndodhë duhet të ketë në dorë raportin e Auditorit Gjeneral të Kosovës për MKK-në me shkeljet e evidentuara.

Muaj më parë pasi që është publikuar raporti i Auditorit Gjeneral për Ministrinë e Kthimit, kryeprokurori i Kosovës, Hilmi Zhiti është takuar me kryeministrin e Kosovës, Agim Çeku. Pas takimit është njoftuar se Zhiti ka marrë raportin e Auditorit në këtë ministri.

Megjithëkëtë, ende asgjë zyrtare nuk është thënë se a kanë filluar hetimet për keqpërdorimet që ka bërë ministri Petković, të cekura në këtë raport.

Ulpiana Lama, zëdhënëse e Qeverisë, thotë se kryeprokurorët mund të takohen me kryeministrin Çeku për të shkëmbyer mendime dhe ide, por që Kryeministria nuk është ajo që inicion hetimet për rastet e keqpërdorimeve.

Ajo ka cituar fjalët e Çekut se Qeveria ka kryer anën politike dhe se pjesa juridike u takon organeve të hetuesisë.

"Raporti i Auditorit Gjeneral për MKK-në është publikuar në faqen zyrtare të saj dhe se organet

mund ta marrin aty këtë raport. Kryeministria nuk dorëzon raportet e auditimit në Prokurori", thotë Lama.

Ndryshe, ende nuk kanë përfunduar hetimet e policisë ndërkombëtare nga bastisja që është bërë më 3 nëntor gjatë një vikendi në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete në lagjen Pepton.

Një burim brenda policisë ndërkombëtare thotë se pas përfundimit të hetimeve në MKK, rezultatet i dorëzohen prokurorit ndërkombëtar, i cili edhe ka dhënë urdhrë për bastisjet në këtë ministri.

"Hetimet do t'i dorëzohen prokurorit ndërkombëtar dhe më pas do të veprohet në bazë të procedurave...", thotë ky burim.

Përveç raportit të auditorit ku janë gjetur një mal me parregullsi, Express ka publikuar edhe fatura të ndryshme, të cilat kanë treguar shpenzime enorme që ka bërë Petković gjatë kohës sa ka qenë ministër.

Angazhim për fatin e të zhdukurve

MITROVICË, 25 NËNTOR

— Kryetarja e Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Personave të të Pagjeturve, Jane

Durgom-Powers, premtoi në Mitrovicë mbështetjen e plotë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve në Kosovë. Powers të premtën në orët e pasdites, ka qëndruar për vizitë në Shoqatën e Familjarëve të të Pagjeturve në Mitrovicë.

Nga kryetari i kësaj shoqate, Bajram Qerkini, është informuar për numrin e të pagjeturve në këtë komunë dhe gjendjen e familjeve të tyre.

"Në komunën tonë kanë qenë të identifikuar si të zhdukur 320 persona, ndërkaq tani kemi 135 sosh", tha Qerkini.

Ai tha se familjarët e të pagjeturve jetojnë në kushte tejet të vështira ekonomike, me theks të veçantë 64 fëmijët bonjakë të cilët nuk kanë asnjërin prind.

"Është me rëndësi të ceket se në shoqatën tonë janë të anëtarësuar 213 gra të cilat kanë mbetur kryefamiljare dhe ato nuk kanë për krahe institucionale, kështu që duke pas parasysh faktin se atyre nuk u është dhënë mundësia të punësohen, gjendja e tyre sociale është e vështirë", tha Qerkini.

Powers nga ana e saj ka premtuar mbështetjen e plotë për çështjen e të pagjeturve, duke thënë se do t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë që Kosovës t'i ndihmojë së pari për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, pasi që deri më tani shumë pak është punuar në këtë drejtim si nga vendorët ashtu edhe nga ndërkombëtarët.

Ajo po ashtu ka premtuar se do të alarmojë organizatat më eminente në botë e posaçërisht në SHBA, për këtë gjendje kaq të rëndë të familjeve të të pagjeturve.